



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPSTINA-STIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

02 Nr. 69
Dt.20.02.2018

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 neni 13, dhe Statutit të Komunës së Shtimes, neni 53, në bazë të Ligjit nr 03/L – 139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, neni 8 pika 5, me ndryshimin dhe plotësimet e bëra me Ligjin 03/L-205 dhe në bazë të vendimit të Kuvendit Komunal - Shtime Npi-01/209 datë 08.07.2016 Kryetari i Komunës, me datë 11.10.2017 mori këtë:

V E N D I M
PËR UDHËHEQJEN E PROCEDURAVE TË SHPRONËSIMIT

- I. TË ZBATOHET** vendimi i Kuvendit Komunal Npi-01/209 datë 08.07.2016 dhe të vazhdohen procedurat për Shpronësimin e pronave të paluajtshme dhe atë. e ngastrës kadastrale nr P-00371-0, në sipërfaqe prej 675 m², Zona Kadastrale Rancë, dhe pjesë e ngastrës kadastrale nr P-01240-0 me sipërfaqe prej 639 m² dhe ngastrën kadastrale nr. P-01241-0 me sipërfaqe prej 851 m² Zona kadastrale Pjetështicë
- II. AUTORIZOHET** – Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi – Sektori për çështje pronësore –juridike që të zhvilloj procedurat e shpronësimit të paluajtshmëris sipas Ligjit nr 03/L – 139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet me ligjin nr 03/L205, në bazë të vendimit të Kuvendit Komunal Npi-01/209 datë 08.07.2016
- III. OBLIGOHET** Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Mjedis- Sektori për pronësi që të udhëheq procedurat për shpronësim në bazë të vendimit të lartëshënuar dhe Zyra Kryesore e Financave që të bëjë kompensimin e pronës së shpronësuar në bazë raportit mbi vlerësimin e pronës nga Ministria e Financave – Departamenti i vlerësimit për pronën e shpronësuar sipas Udhëzimit Administrativ nga Ministria e Financave.

Vendimi hyn në fuqi ditën e marrjes së tij.

Iu dërgohet:

- Arhives
- Drejtorive përkatëse
- Palëve

